



## KOMUNIKATË

**23.09.2009**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur sot, ka miratuar raportin nga mbledhja e kaluar nr. 30/2009. Kryetarja e KQZ-së Nesrin Lushta, në kuadër të aktiviteteve të saj, ka njoftuar anëtarët e KQZ-së lidhur me takimin me kryetarët e Gjykatave Komunale të Kosovës të mbajtur më 17 shtator. Kryetarja Lushta ka thënë se, në takim kanë marrë pjesë 15 kryetar të gjykatave dhe këta kryetar kanë shprehur gatishmërinë për implementimin e ligjit dhe për përkrahjen e procesit zgjedhor.

Kryeshefi i SKQZ-së, Xhemajl Peqani, në kaudër të aktiviteteve të tija, ka informuar se është takuar me drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës z. Behxhet Haliti, e në të cilin takim është kërkar heqja e tatimeve për pagesat e KVV-e dhe stafit teknik të angazhuar për zgjedhjet. Më datën 21 shtator, është bërë shpërndarja e CD-ve me listen preliminare të LV të të gjitha partive politike në nivelin qendror dhe më datën 22, është bërë shpërndarja e CD-ev në të gjitha 36 zyrat e ZE të KKZ-ve. Kryeshefi Xhemajl Peqani, ka informuar edhe lidhur me periudhën e Shërbimit të Votuesëve që ka filluar më 1 shtator, dhe që ka përfunduar më 15 shtator. Gjatë kësaj periudhë zyrat e ZE të KKZ-ve kanë bërë konfirmimin e Qendrave të Votimit 2788 persona, kurse e kanë bërë ndrrimin 1550 persona me të drejtë vote. Gjithashtu, gjatë kohës së operacionit të shërbimit të Votimit Përmes Postës deri më 15 shtator, aplikacione të pranuar përmes postës dhe të marrura nga Mali i zi, janë 2113. Ndërkaq, 516 aplikacione janë pranuar përmes faksit, e-majlit dhe formave të tjera. Si aplikacione të rregullta janë pranuar 2629, nga të cilat janë aprovuar si të vlefshme 1807 kurse, janë refuzuar 822 aplikacione. Kryeshefi Peqani, ka informuar se totali i aplikacioneve të pranuar është 2497 aplikacione.

Lidhur me njoftimin për punën e Këshillave të KQZ-së, kanë referuar Xhelil Pajaziti nga Këshilli për Buxhet dhe Prokurim dhe Ilir Fetahu nga Këshilli për Operacione Zgjedhore. Anëtarët e KQZ-së, me këtë rast kanë miratuar raportin e shpenzimeve për muajin gusht dhe, kanë kërkuar që edhe njëherë të shqyrtohet për rekomandim projekti ECMI “Edukimi i votuesëve në komunat e reja”.

Në këtë mbledhje, anëtarët e KQZ-së kanë shtruar pyetje të ndryshme lidhur me procesin zgjedhor, aspektet organizative të procesit etj.